



4946/19

12.07.2023

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:223312

Datë: 20.06.2023

Numri i dokumentit: 04412173

Ka. nr. 205/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në Kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Azra Cakolli kryetare e Kolegjit, Ramiz Kuqi dhe Skender Çoçaj anëtarë, në çështjen kundërvajtëse ndaj të pandehurit subjektit ekonomik NTH “Bihi”, B.I. me seli në fshatin Duhël - Komuna e Suharekës, me pronar Defrim(Nebih)Hoxha, për kundërvajtje nga neni 7 par. 8, 9 dhe 10 i Ligjit Nr. 08/L-018 për Tregti me Produktet të Naftës dhe Karburanteve të Ripërtitshme, dhe nenit 7 të Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2017 për Cilësisnë e Karburanteve të lëngëta të Naftës, duke vendosur sipas ankesës të paraqitur nga i pandehuri NTH “Bihi”, B.I. me seli në fshatin Duhël - Komuna e Suharekës, me pronar Defrim(Nebih)Hoxha, kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren – Dega në Suharekë - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni i Kundërvajtjes, K.nr. 945/2022, të datës 03.05.2023, në bazë të nenit 55 par. 3 dhe nenit 78, konform të nenit 143 par. 1 dhe par. 2, të Ligjit për Kundërvajtje, Nr. 05/L-087, më datë 16.06.2023, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Duke vendosur sipas ankesës së paraqitur nga i pandehuri Subjekti afarist NTH “Bihi”, B.I. me seli në fshatin Duhël - Komuna e Suharekës, me pronar Defrim(Nebih)Hoxha, sipas detyrës zyrtare

NDRYSHOHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren – Dega në Suharekë - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni i Kundërvajtjes, K.nr. 945/2022, i datës 03.05.2023 216-04/2021, i datës 27.03.2023, sa i përket cilësimit juridik, ashtu që vepra kundërvajtëse për të cilën Subjekti Ekonomik është shpall përgjegjës cilësohet si vepër kundërvajtëse nga neni 13 par. 2 sanksionuar me nenin 19 par. 8 pika 8.3 e Ligjit Nr. 08/L-018 1 për Tregti me Produktet të Naftës dhe Karburanteve të Ripërtrishme, ndërsa gjoba e shqiptuar i mirët si e vërtetuar në shumë prej 1500(njëmijepesëqind)€, të cilën ka për ta paguar në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën nëse gjobën e shqiptuar nuk e paguan në afatin e caktuar e njëjta do të arkëtohet me dhunë sipas Ligjit për Procedurën Përmbarimore.

Në pjesën tjetër aktgjykimi mbetet i njëjtë.

Nga një kopje të këtij aktgjykimi duhet dorëzuar palëve.

Arsyetim

Gjykata Themelore në Prizren – Dega në Suharekë - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni i Kundërvajtjes, sipas Kërkesës për fillimin e procedurës kundërvajtëse të ushtruar nga ana e MTI-së - Inspektorati i Tregut, me numër të Ref. 19/2021 të datës 06.10.2022, me numër të Protokollit 6053-19, me aktgjykim, K.nr. 945/2022, të datës 03.05.2023, të pandehurin NTH “Bihi”, B.I. me seli në fshatin Duhël - Komuna e Suharekës, me pronar Defrim(Nebih)Hoxha, e ka shpall për gjegjëse sepse:

-me datë 29.09.2022, gjatë inspektimit të kryer nga ana e Inspektoratit të Tregut të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, në Prishtinë, tek subjekti ekonomik NTH “Bihi”, B.I. me seli në fshatin Duhël - Komuna e Suharekës, me pronar Defrim(Nebih)Hoxha, shitje me pakicë të NDN-së, janë marrë mostrat e karburantit Dizell dhe Benzinë dhe me datë 30.09.2022, ku kanë rezultuar se produkti i testuar Dizel Jo Conform sa i përket pikës së ndezjes, ka rezultuar 30°C, e duhet të jetë 55 °C, të cilit i është dhënë mundësia në aftë prej 3 ditësh, të kërkon super ekspertizë, mirëpo nuk e ka bërë, me ç veprim i pandehuri ka kryer kundërvajtje nga neni 7 par. 8, 9 dhe 10 i Ligjit Nr. 08/L-018 për Tregti me Produktet të Naftës dhe Karburanteve të Ripërtrishëme, e i ka shqiptuar dënim me gjobë në shumë prej 1500(një mijë pesëqind)€, të cilën gjobë obligohet ta paguaj në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, në të kundërtën gjoba e shqiptuar dhe shpenzimet e lartcekura do të arkëtohet me dhunë sipas dispozitave të Ligjit për Procedurën Përmbarimore.

Me të njëjtin aktgjykim i pandehuri është obliguar që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 5(pesë)€, në afat prej 15 ditësh, nga plotfuqishmëria e aktgjykimit, konform nenit 59 të LK-së.

Kundër këtij aktgjykimi ka ushtruar ankesë i pandehuri NTH “Bihi”, B.I. me seli në fshatin Duhël - Komuna e Suharekës, pronari Defrim(Nebih)Hoxha, për shkak të: shkeljes së dispozitave të procedurës kundërvajtëse, vërtetimit të gabuar dhe jo të drejtë të gjendjes faktike dhe vendimit mbi dënim në të cilën veç tjerash thekson se:

Raporti i inspektimit i datës 30.09. 2022, i bërë nga Trupa inspektuese në kuadër të Ministrisë, nuk është marr parsysh nga ana e gjykatës gjë që ka bërë shkelje të ligjit pasi që po ta kishte shikuar këtë Raport do të nxjerrte Aktvendim mbi Hudhjen e Kërkesës – Fletëparaqitjes. Dënimi i shqiptuar është absurd pasi që tani është i pajisur me çdo dokument përkatës dhe se është duke vepruar konform ligjit duke ju përmbajtur rregullave ligjore. Gjykata e shkallës së parë ka vepruar konform Ligjit ma të favorshëm por ka pasur mundësi të shqipton një dënim minimal pasi që ky dënim i lartë do të vështirëson gjendjen ekonomike të pandehurit. Duke u nis nga vërtetimi i gabuar i gjendjes faktike gjykata gabim ka aplikuar edhe ligjin material andaj aktgjykimi i ankimuar është i paqëndrueshëm, jo i drejtë dhe i kundërligjshëm.

I propozon Gjykatës së Apelit - Divizioni i Kundërvajtjes, që ankesa të aprovohet në tërësi ndërsa aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë të ANULOHEJ dhe procedura të pezullohet.

Kolegji konstatoj se gjykata e shkallës së parë gjatë zhvillimit të procedurës për veprën kundërvajtëse ndaj të pandehurit, në bazë të deklaratës së pronarit Defrim(Nebih)Hoxha të NTH “Bihi”, B.I. me seli në fshatin Duhël - Komuna e Suharekës, të dhënë në Procesverbalin e seancës së datës 15.02.2023, i cili në mbrojtjen e vet ka deklaruar se rezultati i marrjes së mostrave ka rezultuar Jo conform, mirëpo inspektorët kanë ardhur edhe të nesërmen dhe kanë bërë edhe një analizë tjetër e cila ka rezultuar pozitive e pastaj janë larguar dhe i kanë lejuar të punon, në bazë të Procesverbalit mbi Inspektimin e bërë Nr. 00395/22, të datës 29.09.2022,

Raportit Inspektues të "Sierra Lab" SHPK, me Nr. 518/22-TI-M të datës 30.09.2022, i cili ka rezultuar Jo Comform me Dispozitat Rregullative sa i përket pikës së ndezjes, ka rezultuar 30°C, e duhet të jetë 55 °C, si dhe në bazë të shkresave tjera të lëndës, padyshim se e ka vërtetuar gjendjen faktike se i pandehuri ka kryer veprën kundërvajtëse, nga neni 13 par. 2 e sanksionuar sipas nenit 19 par. 3 nën par. 8.3 të Ligjit Nr. 08/L-018 për Tregti me Produktet të Naftës dhe Karburanteve të Ripërtrishme, ndërsa sipas ligjit është i obliguar që të iu garantoj dhe shes klientëve të tij naftë dhe produktet e saj me cilësi ashtu siç e parasheh ligji.

Kolegji, konstatoi se aktgjykimi i shkallës së parë është i qartë, konkret, përmban arsye për të gjitha faktet vendimtare të kësaj çështje kundërvajtëse dhe në arsyetimin e aktgjykimit të kundërshtuar e ka përshkruar gjendjen faktike të cilën e ka vërtetuar si dhe ka dhënë arsyet e qarta për vërtetimin e tillë të fakteve, pasi që Raportit Inspektues me Nr. 518/22-TI-M të datës 30.09.2022, ka rezultuar Jo Comform me Dispozitat Rregullative sa i përket pikës së ndezjes. Ndërsa prezantimi i Raportit të Inspektimit i "Sierra Lab" SHPK, Nr. 519/22-TI-M i datës 30.09.2022, i prezantuar nga i pandehuri në seancë gjyqësore në koje, ka të bëjë me parametra të tjerë, si që është përmbajtja e Sulfurit, pika e densitetit etj, e jo me PIKËN E NDEZJES, andaj me të drejtë nuk është marrë parasysh në rastin konkret.

Kolegji aktgjykimin e ankimuar e shqyrtoi sipas detyrës zyrtare dhe në këtë aspekt gjeti se i njëjti nuk përmban shkelje nga neni 139 të LK-së, e të cilat detyrimisht do ta kishim kushtëzuar prishjen e tij.

Kolegji i kësaj gjykate i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet të tjera ankimore, mirëpo të njëjtat i vlerësoi se janë të pa bazuara dhe të pa qëndrueshme si dhe pa ndikim sepse në shkresa të lëndës ka prova të mjaftueshme në bazë të cilave gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë.

Kolegji konstatoj se, Gjykata e shkallës së parë gjatë zhvillimit të procedurës nuk ka bërë shkelje të dispozitave të procedurës kundërvajtëse, e as shkele të ligjit material kurse gjopa e shqiptuar ndaj të pandehurit, konform nenit 35 të LK-së, në shumë prej 1500(njëmijepesëqind)€, (nën minimumin e paraparë ligjorë për që për person fizik parashihet 3000€), konsiderohet se është përcaktuar sipas shkallës së përgjegjësisë, peshës së veprës së kryer, si rrethanave në të cilat është kryer vepra kundërvajtëse, andaj edhe në këtë drejtim nuk ka bazë ligjore për ndryshimin e aktgjykimit të goditur.

Konform të nenit 143 par.1 dhe par. 3 të LK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi nuk është e lejuar ankesa.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
Ka. nr. 205/2023, me datë 16.06.2023

ANTILBIMET E KOPJES E VERTETON
UDHËHEQËSI I SHKRIMORËS SË GJYKATËS

TAÇNOST KOPIJE POTVRDUJE
RUKOVOĐIOG SUDSKE PISARNICE



KRYETARJA E KOLEGJIT,

Azra Cakolli